

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT

SH. A.



RAPORTI VJETOR I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2021

KUR "HIDRODRINI" SH. A. - PEJË



Shkurt 2022

1. PËRMBAJTJA

1. Përmbajtja	2
Hyrje.....	3
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.....	3
• Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
o Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2021	4
o Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit.....	7
o Një pasqyre e të priturve për vitin 2021.	9
• Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten.....	10
o Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit.....	10
o Plani i Investimet e bëra gjatë vitit 2021	10
o Dividendët e paguara gjatë vitit 2021	10
• Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv.....	10
o Bordi I Drejtorëve në KRU “Hidrodrini “ Sh. A. Pejë ka këtë përbërje.....	10
o Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2021.....	10
o Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2021.	Error! Bookmark not defined.
o Komisioni I Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:.....	Error! Bookmark not defined.
• Informacione të tjera, Rasti i Deçant.....	16
o Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2021	Error! Bookmark not defined.
o Informacione tjera	26
3. Raporti i Zyrarit Kryesor Ekzekutiv.....	16
• Ngjarjet kryesore të vitit 2021	26
• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	27
o Prodhimi i ujit.....	27
o Kualiteti i ujit	Error! Bookmark not defined.
o Çështjet Ligjore.....	28
• Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet	28
• Progresi me planin e Biznesit	35
• Perspektiva për vitin e ardhshëm	35
• Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	36

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës, është pronare e shoqërive aksionare me kapital publik. Kompania e Ujësjiellësit Rajonal "Hidrodrini" SH. A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, të datës 14.07.2009 dhe të Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, të datës 30.09.2009. Shoqëria është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike, Kompania e Ujësjiellësit Rajonal "Hidrodrini" Holding SH. A

Numri popullatës që Kompania Rajonale, "HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 187.000 banor, gjegjësisht me 999.5Km gjatësi të rrjetit të ujësjiellësit ndërsa shërbimet e ujërave të zeza ~ 60,000 banor, gjegjësisht me 162 Km gjatësi të rrjetit të ujerave të zeza. Kapaciteti momental prodhues sillet 24.884.111 m³/vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofrues profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtorëve i përzgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Staf i menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Raporti Vjetor I KRU " Hidrodrini" Sh. A. - Pejë për vitin 2021 është përpiluar duke u bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitën 28.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike të lëshuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike .

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të NP-së ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë, në veçanti, punën e zyrtarëve të Lartë, gjithnjë duke punuar në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësit e Bordit.

Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2021

- ✓ Angazhimi më efikas i punëtorëve në teren.
- ✓ Matje korrekte të konsumit.
- ✓ Reduktimi i humbjeve teknike dhe administrative.
- ✓ Instalim të ujëmatësve në zonat dhe caktimi dhe monitorimi i zonave DMA.
- ✓ Riparim të rrjedhjeve vizuale.
- ✓ Reduktim të sasisë së ujit në zona të caktuara (presioni), menaxhimi i presionit të ujitë.
- ✓ Identifikim të shfrytëzuesve të pa autorizuar.
- ✓ Rritje e numrit të konsumatorëve.
- ✓ Rritjen e investimeve në zëvendësim e gypave të vjetër.
- ✓ Rritja e shkallës së arkëtimit.
- ✓ Hartimi i listave me emra të borxhlive dhe procedimi me Përmbarues.
- ✓ Hartimi i listës investuese me prioritete për donatorët potencial.
- ✓ Ngritja e efikasitetit të stafit.
- ✓ Sistemimi i punëtorëve (Organogrami i ri)
- ✓ Përforcimi i zbatimit të Ligjit dhe Rregulloreve të brendshme.

Gjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2021 kanë marrë vendime dhe kanë dhënë rekomandime apo sugjerime për zgjidhjen çështjeve të ndryshme të cilat kanë pasur ndikim pozitiv në performancën e Kompanisë, si për :

- Rritjen e arkëtimit të borxheve;
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Zvogëlimin e shpenzimeve;
- Furnizimin me ujë të konsumatorëve 24 h/në ditë;
- Kualitetin dhe sasinë e ujit të prodhuar;
- Ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e faturimit si dhe
- Reduktimin e lidhjeve të pa autorizuar.

Kompania Rajonale, “HIDRODRINI” së bashku me BtD gjatë vitit 2021 ka përcjell edhe ecurinë e implementimit të Projekteve.

- Investimet nga Banka Gjermane, Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për Ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza
- Projektin e financuar nga Banka Gjermane faza V dhe VI në vlerë prej 8 mil. € për Pejë, Gjakovë dhe Prizren (rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza dhe incizimi i rrjetit) si dhe zgjerimi i rrjetit dhe rrjetit të ri të kanalizimit si fazë e Kos. VI.
- Si dhe Projektet e Planifikuara sipas Planit të Prokurimit të prezantuar në Anes1.

Në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë, ndër të tjera janë shqyrtuar dhe janë aprovuar edhe këto dokumente :

- Raporti Vjetor i Performancës të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2020 (Vendimi Nr. Prot.6/04/02/2021 dt.03/03/2021)

Edhe gjatë vitit 2021 duke pas parasysh gjendjen me pandemi të shkaktuar nga COVID 19 në vend, KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë, ka respektuar të gjitha masat, duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Raporti Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 ,është përgatitur sipas detyrimeve që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh.A gjatë vitit 2021 ka kryer Aktivitetet e Auditimit, sipas Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 , të aprovuar nga Komisioni i Auditimit. Plani vjetor është përgatitur sipas Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2020-2022.

Gjatë vitit 2021 janë kryer auditimet sipas planit vjetor, ka pasur edhe auditime shtesë apo auditime me kërkesë nga Komisioni i Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2021, ka aprovuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 në mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit.

Tabela I :Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Nr	Përshkrimi i Auditimit	Objektivat e Auditimit	Rekomandimet e dala nga auditimet	Personeli i angazhuar në auditim
1.	Mbikëqyrja e punës së komisioneve regjistruese për stoqet inventarin asetet dhe paranë e gatshme.	Përcjellja e punës së komisioneve regjistruese .	Nuk ka pasur rekomandim.	1
2.	Auditimi i Departamentit Teknik(menaxhim	Funksionimi dhe mbarëvajtja e Departamentit	7 rekomandime, prej të cilave dy	1


	i i prodhimit dhe humbjeve të ujit)	Teknik.	rekomandime kanë gjetur zbatim gjatë viti 2021 dhe 5 të tjera në proces.	
3.	Auditimi i Departamentit Komercial(menaxhimi i faturimit dhe inkasimit)	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punëve në këto njësi operative.	2 rekomandime , prej të cilave një rekomandim ka gjetur zbatim gjatë vitit.	1
4.	Auditim me kërkesë të Komisionit të Auditimit(Ndryshimet e vendeve të punës në KRU Hidrodrini Sh.A)	Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave për ndryshimet e pozitive të punës.	2 rekomandime, të cilat kanë nisur të gjejnë zbatim gjatë vitit.	1
5.	Auditimi në Departamentin e Administratës(me naxhimi i mbrojtjes dhe sigurisë në punë)	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës në këtë zyrë – njësi.	3 rekomandime ,të cilat janë në proces të zbatimit.	1
6.	Auditimi me Kërkesë të Komisionit të Auditimit(auditimi i procesimit të pagave Tm2/2021).	Procesi i kalkulimit të pagave për periudhë TM2/2021.	1 rekomandim,i cili është zbatuar gjatë vitit 2021.	1
7.	Departamenti Komercial(auditimi i i menaxhimit të inspektimeve)	Mbarëvajtja e punës së ekipeve të inspektimit.	4 rekomandime , të cilat priten të zbatohen në vazhdimësi.	1

8.	Departamenti Financiar	Funksionimi dhe mbarëvajtja e depove, menaxhimi i stoqeve në të gjitha njësitë operative.	2 rekomandime , të cilat priten të zbatohen në vazhdimësi.	1
9.	Plani Vjetor për vitin 2022.	Përgatitja e planit vjetor për vitin 2022		1
10.	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2020-2021	Përcjellja dhe monitorimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dala gjatë vitit 2020-2021.		1


Aktivitetet e Auditimit gjatë vitit 2021 janë realizuar sipas afateve kohore të parapara në Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021.

Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit

Vitet	2017	2018	2019	2020	2021	Planifikuar 2021
Prodhimi (m3)	25,659,967	25,336,310	25,024,278	24,881,385	24,854,111	24,900,000
Faturimi (m3)	9,266,841	10,031,334	10,311,374	10,289,074	10,769,955	10,347,000
Humbjet (%)	62%	60%	58.80%	58.58%	57%	57%
Shpenzimet (euro)	2,448,283	2,501,846	2,549,860	2,577,415	2,929,290	2,928,000



Vitet	2017	2018	2019	2020	2021	Planifikuar 2021
Faturimi (euro)	3,644,856	3,754,879	3,937,043	3,795,599	3,977,082	4,155,502
Arketimi (euro)	2,912,768	322,363	3,681,587	3,271,083	4,989,333	3,865,547
shkalla (%)	80%	86%	94%	86%	125%	93%
Norma e mbuleses se punës	1.21	1.30	1.47	1.50	1.70	1.34



Gjatë vitit 2021, inkasimi /arkëtimi është realizuar 125 %, pra, me shumë se planifikimi, apo ne vlerë monetare me shumë për **1.123.786 euro**.

Norma e mbulesës së punës gjatë viteve 2017 - 2021:

2017.....1,21,

2018.....1,30,

2019..... 1,47,

2020.....1,50,

2021.....1,70

Në të gjitha vitet është siguruar qëndrueshmëria.

(Ky është raporti në mes hyrave dhe shpenzimeve).

Humbjet ujit gjatë viteve:

Viti 2017.....62%,

Viti 2018.....60%.

Viti 2019.....58.70%,

Viti 2020.....58.58%,

Viti 2020.....57%.

Një pasqyrë e planifikimit dhe realizimit për vitin 2021

Aktiviteti	Viti 2021	Planifikuar Viti 2021
Faturimi (€)	3,977,082	4,155,502
Inkasimet (€)	4,989,333	3,865,547
Shkalle në %	128%	93%
Norma mbulesës	1.7	1.34
Uji i Pa faturuar %	57%	57%

Shënim:

Uji i pa faturuar sipas planifikimit është 57%, kurse ai i realizuar 57%,

Shpenzimet gjate vitit 2021 janë **2,928,000 euro**, kurse te hyrat **4,989,333 euro**.

Kemi mbulim te shpenzimeve dhe një mbetje prej **2,061,333 euro**.

Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten

Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2021 nuk kemi pasur dhe as nuk kemi iniciuar ndonjë marrëveshje me institucionet financiare për huazim ose tërheqje te kredisë.

Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2021

Nga Donatoret:

1. Impianti i Trajtimit të Ujerave të Zeza në Pejë. Kosova IV. (duke u implementuar),
2. Fillimi i Procedurave për projektin Kos. VI , rehabilitimi i rrjetit te Kanalizimit dhe zgjerimi,

Nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. – Pejë:

Vazhdimësi:

Dividendët e paguara gjatë vitit 2021

Meqenëse Kompania e Hidrodrinit për vitin 2021, ka një fitim prej duku **479,720 €** nga aksionari nuk është kërkuar që dividendat të paguhet.

Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv

Bordi I Drejtorëve në KRU " Hidrodrini " Sh. A. Pejë ka këtë përbërje

Bazuar në Vendimin e Nr.09/107 të dt.18.06.2019 të Qeverisë të Republikës së Kosovës, Bordi i Drejtorëve në KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, ka këtë përbërje :

1. Ztr.Demë Abazikryesues
2. Ztr.Valon Haxhijaj.....anëtar
3. Ztr.Vllaznim Pergjegjaj.....anëtar
4. Ztr.Naim Tahiri.....anëtar
5. Ztr.Musë Mushkolajanëtar
6. Ztr.Nimon Zeneli.....anëtar

Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë :

Emri Mbiemri	Pozita	Paga
Demë Abazi	Kryesues	4.275
Valon Haxhijaj	anëtar	3.040
Vllaznim Përgjegjaj	anëtar	3.040
Naim Tahiri	anëtar	3.040
Musë Mushkolaj	anëtar	3.040
Nimon Zeneli	anëtar	3.040
Bordi i Përkohshëm		
Emri Mbiemri	Pozita	Paga
Bajram Mustafa	Kryesues	1.125
Luljeta Lutfiu	anëtar	800
Zamire Beqiri	anëtar	800
Abedin Neziraj	anëtar	800

Bazuar në Vendimin e Nr.33/39 të dt.13.10.2021 të Qeverisë të Republikës së Kosovës, është përzgjedhur Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve në KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë i cili ka këtë përbërje :

- 1.Ztr. Bajram Mustafakryesues
- 2.Znj. Zamire Deçani/Beqiri.....anëtare
- 3.Znj. Luljeta Krekaj/Lutfiu.....anëtare
- 4.Ztr. Abedin Neziraj.....anëtar

Numri i Mbledhjeve te Bordit të Drejtorëve të mbajtura gjatë vitit 2021:

KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë				
Nr.	Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	28.01.2021	11,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr. Agron Tigani - KE . Të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
2	E rregullt	03.03.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Naim Tahiri, Ztr.Musë Mushkolaj dhe Ztr.AgronTigani – KE. Të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami – Sekretare
	E rregullt	26.03.2021	11,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Demë Abazi,

3				Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.Valon Haxhijaj. Të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami – Sekretare.
4	E rregullt	30.04.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.Agron Tigani - KE Të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
5	E rregullt	28.05.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.AgronTigani - KE dhe të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
6	E rregullt	01.07.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.A.Tigani - KE dhe të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
7	E rregullt	30.07.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.Agron Tigani - KE dhe të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
8	E rregullt	03.09.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.Agron Tigani - KE .Të ftuar tjerë Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
9	E rregullt	30.09.2021	10,00	Bordi i Drejtorëve : Ztr.Demë Abazi, Ztr.Valon Haxhijaj, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli, Ztr.Musë Mushkolaj, Ztr.Naim Tahiri dhe Ztr.AgronTigani - KE dhe Ztr.Rasim Maloku ZLF dhe Znj.Vjollca Imami - Sekretare
10	Konstituive	22.10.2021	12,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Bajram Mustafa - kryesues, Znj.Zamire Deçani/Beqiri, Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu, Ztr.Abedin Neziraj-anëtar/e dhe Ztr.Agron Tigani-KE. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku – ZLF,Znj.Vjollca Imami – Sekretare dhe Znj.Aurora Dinaj - ZAB
11	E rregullt	29.10.2021	12,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Bajram Mustafa -

				kryesues, Znj.Zamire Deçani/Beqiri, Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu, Ztr.Abedin Neziraj-anëtar/e dhe Ztr.Agron Tigani-KE. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku -ZLF, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
12	E rregullt	01.12.2021	12,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Bajram Mustafa - kryesues, Znj.Zamire Deçani/Beqiri, Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu, Ztr.Abedin Neziraj-anëtar/e dhe Ztr.Agron Tigani-KE. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku – ZLF,Znj.Vjollca Imami – Sekretare
13	E rregullt	28.12.2021	11,00	Bordi i Drejtorëve: Ztr.Bajram Mustafa - kryesues, Znj.Zamire Deçani/Beqiri, Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu, Ztr.Abedin Neziraj-anëtar/e dhe Ztr.Agron Tigani-KE. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF dhe Znj.Vjollca Imami – Sekretare
14	MPVA	29.12.2021	10,00	Të autorizuarit e Aksionarit Ztr.Mentor Arifaj - Zëvendës Minister i Ministrisë së Ekonomisë, Znj. Filloreta Gashi analiste pranë NJPMNP. Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë me këtë përbërje: Ztr.Bajram Mustafa-kryesues, Znj.Zamire Deçani/Beqiri, Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu dhe Ztr.Abedin Neziraj - anëtar/e si dhe Ztr.Agron Tigani – Kryeshef Ekzekutiv. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF, Znj.Vjollca Imami – Sekretare dhe Znj.Aurora Dinaj - ZAB

Mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit të mbajtura gjatë vitit 2021:

Bazuar në Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Nr.prot. 1763 të dt.22.07.2019 është përzgjedhur Komisioni i ri i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë me këtë përbërje:

1. Ztr.Valon Haxhijajkryesues
2. Ztr. Vllaznim Pergjegjaj.....anëtar
3. Ztr.Nimon Zeneli anëtar

Bazuar në Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Nr.prot. 2707 të dt.26.10.2021 është përzgjedhur Komisioni i ri i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë me këtë përbërje:

- 1.Znj.Zamire Deçani/Beqiri.....kryesuese
- 2.Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu.....anëtare
- 3.Ztr.Abedin Neziraj.....anëtar

Mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit të mbajtura gjatë vitit 2021:

Nr.	Mbledhjet e Komitetit të Auditimit	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	26.01.2021	10,00	Komisioni i Auditimit: Ztr.Valon Haxhijaj- kryetar, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj dhe Ztr.Nimon Zeneli- anëtarë. Të ftuar : Ztr.Rasim Maloku –ZLF , Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
2	E rregullt	26.02.2021	10,00	Komisioni i Auditimit : Ztr.Valon Haxhijaj –kryetar Ztr.Vllaznim Pergjegjaj dhe Ztr.Nimon Zeneli- anëtarë.Të ftuar tjerë Ztr.Agron Tigani – KE dhe Znj.Vjollca Imami Sekretare
3	E rregullt	23.03.2021	11,00	Komisioni i Auditimit : Ztr .Valon Haxhijaj -kryetar Ztr.Vllaznim Pergjegjaj dhe Ztr.Nimon Zeneli-anëtarë Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF, Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
4	E rregullt	22.04.2021	10,00	Komisioni i Auditimit : Ztr .Valon Haxhijaj-kryetar, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj dhe Ztr.Nimon Zeneli-anëtarë Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF, Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
5	E rregullt	24.05.2021	10,00	Komisioni i Auditimit: Ztr.Valon Haxhijaj-kryetar dhe Ztr.Nimon Zeneli – anëtarë. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF , Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
6	E rregullt	24.06.2021	10,00	Komisioni i Auditimit:

				Ztr.Valon Haxhijaj-kryetar, Ztr.Vllaznim Pergjegjaj dhe Ztr.Nimon Zeneli –anëtarë. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku –ZLF , Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
7	E rregullt	27.07.2021	10,00	Komisioni i Auditimit: Ztr.Valon Haxhijaj- kryesues, dhe Ztr.Nimon Zeneli –anëtarë. Të ftuar tjerë: Ztr.Rasim Maloku – ZLF, Znj.Aurora Dinaj ZAB, Znj.Vjollca Imami – Sekretare
8	E rregullt	31.08.2021	10,00	Komisioni i Auditimit : Ztr.Valon Haxhijaj dhe Ztr.Nimon Zeneli -anëtarë si dhe Znj.Aurora Dinaj ZAB, Ztr.Rasim Maloku – ZLF, Znj.Vjollca Imami - Sekretare
9	E rregullt	23.09.2021	10,00	Komisioni i Auditimit : Ztr.Vllaznim Pergjegjaj, Ztr.Nimon Zeneli -anëtarë si dhe Znj.Aurora Dinaj ZAB, Ztr.Rasim Maloku – ZLF dhe Znj.Vjollca Imami -Sekretare
10	E rregullt	24.11.2021	11,00	Komisioni i Auditimit : Znj.Zamire Deçani/Beqiri Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu dhe Ztr.Abedin Neziraj – anëtar/e si dhe Znj.Aurora Dinaj ZAB, Ztr.Rasim Maloku –ZLF , Znj.Vjollca Imami -Sekretare
11	E rregullt	23.12.2021	11,00	Komisioni i Auditimit : Znj.Zamire Deçani/Beqiri Znj.Luljeta Krekaj/Lutfiu dhe Ztr.Abedin Neziraj – anëtar/e si dhe Ztr. Agron Tigani-KE dhe Znj.Vjollca Imami-Sekretare

Informacione te tjera

Rasti i Deçanit

Raporti i masave te Ndërmarrë nga KRU “Hidrodrini”Sh. A. - Pejë

Aktivitetet e Ndërmarrë nga KRU “Hidrodrini”Sh. A. – Pejë, ne lidhje me dyshimet e infektimit te ujit ne Njësinë Operative Deçan, per Fshatrat te sistemit të Ujësjellësit Prejlep, Rastovice, Irzniq, Gllogjan, Shaptej, Gramaqel, Baballoq, Ratish dhe Jasiq i ri.

Te reshurat kane filluar te Shtunën me 10.07.2021, diku pas dite kah ora 17h, të cilat kanë zgjatë gjatë tërë natën. Te dielën ne mëngjes duke filluar nga ora 9h, pas marrjes se informatës me datën 11.07.2021 nga QKMF Deçan, se disa qytetarë te Komunës se Deçanit kane kërkuar ndihme mjekësore ne QKMF Deçan për shkak te vjeljeve dhe bark qitjeve, ekipi ynë dhe ekipet e ISHPK, ne krye me Dr. Burim Kotorin kane shkuar ne për marrjen e mostrave te ujit ne 6 fshatra te Komunës se Deçanit.

Fillimisht janë takuar me Menaxherin e Njësisë se KUR “HIDRODRINI” te Deçanit, Drejtorin e Shëndetësisë dhe te QKMF, Togerin e Stacionit policor ne Deçan , si dhe pjesëtarët e KFOR-it.

Sipas informatave nga Drejtori i QKMF behet fjale për afro 200 persona qe nga pasditja e djeshme kane kërkuar ndihme mjekësore ne QKMF Deçan për shkak te simptomave te vjelljes dhe bark qitjes.

Te gjithë janë trajtuar aty dhe janë lëshuar ne shtëpi ne gjendje te përmirësuar dhe nuk kemi asnjë referim për hospitalizim ne Spitalin e Pejës.

Aktivitetet që janë Ndërmarr:

1. Janë marre mostrat e ujit për analizë fiziko kimike dhe bakteriologjike ne 6 fshatra te Komunës se Deçanit: Prilep, Irzniq, Gramaqel, Baballoq, Rastavicë dhe Gllogjan. Te gjitha këto fshatra furnizohen nga një burim dhe mostrat janë marrë ne kroje publike te këtyre fshatrave.
2. Është kërkuar nga Drejtori i QKMF lista e te gjithë pacientëve me adresa dhe kontakte te trajtuar si te dyshimtë ne “helmim” me ujë, dhe nga nesër ekipi i Shërbimit te Epidemiologjisë do te bej hulumtimin aktiv te terrenit me marrjen e anketave epidemiologjike.
3. Janë dhëne rekomandime qe mos të përdoret uji për pije deri ne rezultate përfundimtare nga laboratorit ynë dhe është marre vendim nga kryetari i Deçanit qe uji te mos lëshohet te ndërpritet.

Me datën 12.07.2021, pas takimit e Kryetarin e Deçanit, Drejtorin e Shëndetit ne Deçan, ISHPK-në, Policin e Kosovës dhe Hidrodrinin ka marre këto aktivitete:

1. Kontrolli i burimit te Ujitë, si dhe kontrolli i te gjitha pusetave nga burimi deri ne rezervuar,
2. Kontrolli dhe pastrimi i Rezervuarit kryesor, larja e mureve si dhe dezinfektimi i tij,



3. Kontrolli i rrjetit si dhe pastrimi i tij, ne pikat shpëlarëse,
4. Dezinfektimi i tubacionit kryesor,
5. Me datën 13.07.2021, ne takimin e ekipit emergjent kemi marre vendim qe ujit te lëshohet nga ora 14h, ku KRUH, ka bere lëshimin e ujitë, si dhe kemi dal me komunikatë që Uji te përdoret vetëm për nevoja sanitare, pra te mos përdoret për pije.
6. Nga KRUH, Kontrolli i përsëritur i burimeve, rezervuarëve si dhe rrjetit te Ujësjellësit.
7. Me datën 16.07.2021, është ftuar Ekipi Laboratorik nga Gjakova, i cili është i akredituar, për marrjen e mostrave te Ujitë, si dhe Hiperklorinimi i sistemit, KONTROLLA E UJIT NE RAJONIN E PEJES (HIDRODRINI) DECAN.



Pas këtyre kontrolleve, dhe pas bisedave me banorë te ndryshëm duke u munduar te marrim veprimet me te mira, pas një bashkëpunimi te ngushte me dy Stafet e Labororit të Hidrodrinit dhe Gjakovës, kemi vërejtur që po thuajse te gjithë banorët e këtyre fshatrave përdorin ujë

hidrofori (bunari) si ujë, primare para atij të Hidrodrinit duke u arsyetuar në mënyra të ndryshme: nga uji i sistemit nuk kemi shtypje, jemi mësuar me ujë të hidroforit, kishte banore që kur kërkonim të merrnim një mostër në shtëpinë e tijë përgjigja ishte që ai kishte dy muaj pa e përdorur ujin e sistemit. Në shtëpinë e familjes Selmanaj nga fshati Glllogjan kemi marrë mostër nga uji i bunarit dhe pas shpëlarjes së rrjetit të shtëpisë me ujë të hidrodrinit kemi marrë mostër nga po ky ujë. Gjate mostrimit kemi vërejtur që të dy sistemet kanë qene në funksion njëkohësisht ku shtypja e hidroforit ishte 3-4 here më e madhe se e sistemit dhe dyshojmë që ka mundur të depërtoj në rrjet, si në shumë familje tjera ku dyshojmë për të njëjtin veprim.

Analizat nga KRU "Gjakova" Sh. A. Janë në dispozicion, si dhe procesverbalet nga terreni të dokumentuara me foto.

8. KRU Hidrodrini ka dal me një urdhërese me anë të cilës u është kërkuar të gjithë konsumatorëve të zonës së shërbimit nga KRU Hidrodrini që të bëjnë ndarjen e rrjeteve të ujësjellësit nga ai i bunarëve.

Me datën 09.08.2021, nga tre mostrat e ISHPK, kemi: **matja 01, e datës 22.07.2021**, Janë marrë gjithsej 7 mostra të ujit për pije në pikat e mostrimit: në rezervoarin Drenoc, rrjeti i ujësjellësit fshati Prilep, Irzniq, Glllogjan, Gramaqel, Baballoq, Rastavicë. Në të gjitha pikat e mostrimit uji është i klorinuar dhe vlerat e klorit rezidual janë prej 0.02mg/L (fshati Gramaqel) - 0.3 mg/L (fshati Prilep).

Në pikën mostruese në fshatin Gramaqel në analizën kimike kemi tejkalim të vlerës së lejuar të turbiditetit -NTU 10.30 dhe vetëm gjurmë të klorit rezidual.

Pika e vetme e mostrimit në rrjet të ujësjellësit në këtë fshat është kroi publik në oborrin e shkollës fillore, ndërsa në të njëjtën pikë është i kyqur edhe pusi i shkollës me c' rast vjen deri të komunikimi në mes të ujit nga rrjeti i ujësjellësit me ujin nga pusi.

- Në analizën bakteriologjike të mostrave të ujit në fshatin Gramaqel dhe fshatin Baballoq janë izoluar baktere anaerobe sulfidoreduktuese.
 - Uji për pije në fshatin Gramaqel dhe fshatin Baballoq nuk i plotëson standardet e parapara sipas UA 16/2012.
 - Mostrat nga rezervuari Drenoc, fshatrat: Prilep, Irzniq, Glllogjan dhe Rastavicë, rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin për konsum human të përcaktuara sipas UA 16/2012.
9. Aktivitet I KRU "Hidrodrini" është bere shkyçja e bunarit i cili komunikon me sistem të ujësjellësit, si dhe kontrolli i dy fshatrave (Graqel dhe Baballoq) në të gjitha amvisnit.

Matja 02, e datës 26.07.2021, janë marrë 12 mostra të ujit për pije në Rezervoarin Drenoc, fshati: Prilep, Irzniq, Gllogjan, Gramaqel, Baballoq, Rastavice, Ratish i Ulët, Ratish i Epërm, Prekolluk, Dubravë, Jasiq i Ri.

Mostrate e ujit në pikat e mostrimit: Rezervoari Drenoc, fshati Prilep, Irzniq, Gllogjan, Gramaqel, Ratish i Epërm, Jasiq i Ri rezultojnë brenda standardeve të parapara me UA 16/2012.

Fshatrat (Ratish i Ulët, Baballoq, Rastavicë) nuk kane permbush standardet e parapara

10. Aktivitet I KRU”Hidrodrini” fokusimi ne fshatrat e sipërm, eliminimi i te gjithë bunarëve ngas rrjeti I Ujësjellësit. Aktivitet I cili është ende ne vazhdimësi.

Matja 03, e datës 27.07.2021

Janë marr gjithsej 8 mostra të ujit për pije: Rezervoari Drenoc, fshatrat: Drenoc, Prilep, Prekolluk, Irzniq, Gllogjan, Baballoq dhe Rastavicë.

Vlera e klorit rezidual në pikat e mostrimit është 0.2 mg/L.

Të gjitha parametrat kimike janë në përputhshmëri me standardet e parapara me UA 16/2012.

Në Gramaqel nuk është marrë mostra për arsye se nuk kishte furnizim me ujë në rrjet (si rezultat i ndërhyrjes së personave të pa autorizuar në valvulat shpërndarëse në pusetat e rrjetit të ujësjellësit) dhe në pikën e mostrimit në kronin publik është i kyqur pusi i shkollës.

Gjithashtu, edhe në fshatrat Ratish i Ulët, Ratish i Epërm, Dubrave, Jasiq i Ri nuk janë marrë mostra uji për arsye se nuk ka kroje publike të rrjetit të ujësjellësit, dhe të gjitha shtëpitë private i kanë pusët e kyçura në rrjetin e ujësjellësit.

Në analizën bakteriologjike të mostrave të ujit në pikat e mostrimit: Rezervoari Drenoc, fshati: Drenoc, Prilep, Prekolluk, Irzniq, Gllogjan, Baballoq, Rastavicë nuk ka kontaminim bakteriologjik.

Të gjitha mostrat e ujit të analizuarra më 27.07.2012 rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin për konsum human të përcaktuara sipas UA 16/2012.

Njoftim: Janë formuar ekipe për eliminimin e kyçjeve ilegale si dhe kyçjeve te sistemit te cilat fshataret i kane lidhur bunarët pa standarde.

Ne takimin e datës, 11.08.2021, është hartuar strategjia e përmbushjeve e Rekomandimeve te IKSHPK, ku do te raportohet me aktivitete e kryera, (Pra përmbushja e Rekomandimeve, ashtu që 3 matjet e ardhshme te jene te gjitha sipas standardeve sikurse matja e tret e datës 27.07.2021.

KONKLuzionet e Takimit
PËR Cilësinë e Ujit në Komunën e Deçanit
 i mbajtur më 10 gusht 2021

DATË:	10 gusht 2021; ora 11:00
VENDI:	Pejë, ndërtesa e KRU Hidrodrini, salla e takimeve
QËLLIMI I TAKIMIT:	<i>Prezantimi i raportit të IKSHPK me gjetjet nga hulumtimi i kryer për epideminë e Gastroenterokolitit në komunën e Deçanit si dhe rezultateve të monitorimit të cilësisë së ujit dhe rekomandimeve për sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm nga sistemi i furnizimit me ujë.</i>
PJESËMARRËS:	<ol style="list-style-type: none"> 1) Znj. Burbuqe Nushi-Latifi, Koordinatore e Qendrës së Ujit – IKSHPK/MSH 2) Z. Burim Kotori, QRSHP/MSH 3) Z. Afrim Lajçi, Këshilltar – Këshilli Ndërmintrosor për Ujëra/ZKM 4) Z. Besim Imeri, Udhëheqës i NJPM të NP – Ministria e Ekonomisë 5) Znj. Zoge Spahiu, Udhëheqëse e Inspeksionit – ARRU 6) Z. Abdullah Dërguti, Drejtor Menaxhues - SHUKOS 7) Z. Musë Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi – komuna e Deçanit 8) Z. Musë Mushkolaj, anëtar i Bordit – KRU Hidrodrini 9) Z. Agron Tigani, Kryeshef Ekzekutiv – KRU Hidrodrini 10) Znj. Feride Gjoci, Përgjegjëse për Cilësinë e Ujit – KRU Hidrodrini

1. Të përgatitet një raport për masat e ndërmarra nga ana e KRU Hidrodrini në lidhje me sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm në komunën e Deçanit konform rekomandimeve të IKSHPK. Raporti t'i dërgohet IKSHPK, ARRU, NJPM të NP, komunës së Deçanit, dhe Këshillit Ndërmintrosor për Ujëra.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini

Afati: 11 gusht 2021 **I PERMBUSHUR I DERGUAR.**

2. Të kryhet përkufizimi i zonave të furnizimit me ujë në sistemet e ujësjellësit në komunën e Deçanit për qëllime të monitorimit të cilësisë së ujit.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini në bashkëpunim me QRSHP në Pejë

Afati: 13 gusht 2021 **I PERMBUSHUR I DERGUAR.**

3. Të trajtohet dhe sipas nevojës të kompletohet procesi i bartjes së aseteve nga komuna e Deçanit te KRU Hidrodrini për të gjitha sistemet e ujësjellësit të kësaj komune.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini në bashkëpunim me komunën e Deçanit dhe NJPM të NP

Afati: 30 shtator 2021 **AKTIVITET NE VAZHDIMESI**

4. Të dorëzohet kërkesa për leje ujore në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për të gjitha burimet të cilat shfrytëzohen nga KRU Hidrodrini e për të cilat nuk ka leje ujore.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit

Afati: 31 gusht 2021. **DESHMI PER APLIKIM TE LEJEVE UJORE, SI DHE LEJET UJORE TE CILAT DO TE PREZENTOHEN NE BORD.**

5. Të hartohet projekti për punimet e nevojshme për rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit për fshatrat e Deçanit të cilat furnizohen me ujë nga burimet Gurra e Hasanagës dhe Kurvalla, me të cilat punime do të ngritje siguria fizike e komponentëve të sistemit nga ndotja si dhe do të sigurohej cilësia e ujit në pajtim me standardet dhe legjislacionin e zbatueshëm. Këto punime, ndër tjera, duhet të përfshijnë: (i) rehabilitimin e veprës ujëmarrëse me qëllim që të evitohet hyrja e ujërave sipërfaqësore në rrjet, (ii) instalimin e sistemit adekuat të klorizimit që do të mundësonte dezinfektim pandërprerje të ujit dhe prezencën e klorit rezidual në të gjithë rrjetin e ujësjellësit (iii) sigurimin fizik të veprës ujëmarrëse, rezervuarit, pusetave për shuarje të presionit etj., (iv) eliminimin e lidhjeve të puseve individuale me rrjetin e ujësjellësit, (v) vendosjen e ventilave të cilat mundësojnë shpëlarjen e rrjetit të ujësjellësit, (vi) instalimin e pikave/rubinetave për marrjen e mostrave nga rrjeti i ujësjellësit, etj.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini

Afati: 31 gusht 2021 **Projekti detal i hartuar dhe i dorezuar ne KK-Deçan, me vlerë prej diku 150.000 euro**

Rekomandimi 06.

Të zbatohen punimet sipas projektit nga pika 5. më sipër në rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit me të cilin furnizohen me ujë fshatrat e komunës së Deçanit nga burimet Gurra e Hasanagës dhe Kurvalla me mjetet financare të ndara nga Qeveria e Kosovës për këtë qëllim.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini

Afati: 31 dhjetor 2021 **Projekti se bashku me KK- Deçan eshte hartuar dhe dorezuar ne KK-Deçan, nga Komuna eshte perzgjedh Kontraktori "Hidroprojek", Punet kane filluar,por pjesa kryesore e projektit nuk ka perfunduar.**

Rekomandimi 07

Të identifikohen dhe të ndërpriten lidhjet e drejpërdrejta të puseve individuale me rrjetin e ujësjellësit në komunën e Deçanit dhe komunitat tjera të cilat furnizohen me ujë nga KRU Hidrodrini.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini me mbështetjen e autoriteteve komunale

Afati: 30 shtator 2021 Me kete aktivitet kemi filluar, aktivitet i permbushur nga KRUH.(Janë vendosur ventila jokethyes ne pikat ku ka pasur lidheshmeri rrjeti i Ujësjetllësit me Bunare), sipas tabelarit

KRU Hidrodrini ka marrë te gjitha masat dhe ne te gjitha fshatrat e këtij sistemi ka punuar dhe me date 01.10.2021 ka përfunduar rekomandimin e marra nga IKSHPK

Emërtimet e fshatrave	Ventila jo kthyes	Riparime te tjera
Prejlep	46	71
Rastovice	25	125
Irzniq,	26	106
Glllogjan	14	80
Shaptej	4	46
Gramaqel,	31	76
Baballoq	3	72
Ratishe	24	60
Jasiq I ri	4	19
Prekolluke	0	27
Dubrave	0	24

Ku kemi 706 riparime dhe 177 Bunar qe kane pasur lidhje me sistemin tonë janë vendosur ventila Jo kethyes.

Ne vazhdim mund te shohim se çfarë është punuar ne këto fshatra.



Ku shihet përmytje nga Shirat.

Në vazhdim shikoni raportin E Pranuar me datën 11.10.2021, nga IKSHPK

Raport i rezultateve të analizës së mostrave të ujit për pije në rrjetin e ujësjellësit Drenoc-Komuna, Deçan

Në bazë të të dhënave të marra nga KRU Hidrodrini, është përcaktuar zona e furnizimit, pikat e mostrimit dhe frekuenca e mostrimit në pikat e ujësjellësit të burimit të Kurvalles dhe Hasanages.

Nga mostrat e ujit për pije për analize fiziko -kimike dhe bakteriologjike (1 +1) me dt:

26.07.2021 2 mostra - fiziko -kimike dhe bakteriologjike

27. Korrik 2021 8 mostra - fiziko -kimike dhe bakteriologjike

16.08.2021 4 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

24.08.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

31.08.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

07.09.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

14.09.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

21.09.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

05.10.2021 2 mostra- fiziko -kimike dhe bakteriologjike

Nga rezultatet e analizave te këtyre mostrave kemi këto te dhëna :

Mostra me dt. 31.08.2021 ne piken e mostrimit ne Glllogjan rezulton me tejkalim te vlerës se përcaktuar për turbullire.

Mostra e dt. 05.10.2021 ne piken e mostrimit ne Gramaqel, vlera e Klorit rezidual eshte 0.0 dhe ka kontaminim me baktere koliforme dhe E.Coli. Kjo pike është mjaft diskutabile për arsye te komunikimi ne mes te rrjetit te ujësjellësit dhe ujit te pusit te shkollës ne rrjetin e ujësjellësit (nese nuk është eliminuar deri me tani) dhe gjithashtu ka dyshime se ka ndonjë edhe ndonjë kyçje tjetër ilegale ne rrjet apo defekti te mundshëm te rrjetit.

Parametrat e tjerë ne te gjitha pikat e mostrimit janë ne përputhshmëri me vlerat te përcaktuara me standarde për ujë te pijes.

Vlera e klorit rezidual ne pikat e mostrimit është prej 01.-0.3

Mostrimi i këtyre pikave te përcaktuara sipas zonës se furnizimit dhe frekuencës se mostrimit do te realizohen ne vazhdimësi ne ato fshatra ku ka qasje ne kronin publik te fshatit ne kuadër te Monitorimit Ekstern te përcaktuara sipas planit nga QRSHP Peje.

Dr. Burim Kotori

Ekologji Humane


QRSHP Peje

11.10 2021

Shënim: Gjate aktivitetit te Hidrodrinit ne fshatin Gramaqel ne kemi bere ndarjen Fizike te bunarit Ne së bashku me Dr. Burim Kotorin jemi duke monitoruar ketë pik, ku edhe me kontrole shtesë do te bëjmë kontrollimin se mos ka ndonjë kycje Ilegale që mund ta kontaminoj Ujin nga sistemi I Ujësjiellit.

12.10.2021

Kemi kontaktuar stafin e shkollës dhe drejtorin ne Gramaqel, pas kontrollit kemi zbuluar se shkolla furnizohet edhe me nje bunar(Pus) kemi intervenuar me shkyçje.



8. Të identifikohen, të procedohen penalisht dhe të ndërpriten e të gjitha lidhjet (kycjet) ilegale në rrjetin e ujësjiellit, me qëllim të kontrollit të konsumit të ujit dhe sigurimit të furnizimit te pandërprere të ujit nga sistemi i ujësjiellit për konsumatorët e komunës së Deçanit dhe komunave tjera që furnizohen me ujë nga KRU Hidrodrini.

Përgjegjësi e: KRU Hidrodrini me mbështetjen e autoriteteve komunal

Në Vazhdimësi.

